

## Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.38 Regj. Themeltar, Datë 13.09.2023 Regjistrimi, me:

- Paditës:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa.
- I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ.
- Person i interesuar:** Partia e Lirisë, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj.
- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit nr. 181, datë 07.09.2023, të KAS “Për rishqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga Partia Politike “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
- Ndryshimi i vendimit të Komisionerit nr. 722, datë 19.08.2023, duke e ndryshuar në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 1 të tij, si më poshtë:
- b) dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike” (PDSH)
- c) një anëtar propozohet nga “Partia e Lirisë”.

Më datë **14.09.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare).**

Me Urdhër datë 14.09.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **15.09.2023, ora 08:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.

**Tiranë, më 14.09.2023**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**